



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:111290
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05480014

PAKR.nr.15/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda– kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Abdullah Ahmeti - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Blerina Sallauka, në çështjen penale kundër të pandehurit S. H nga ...- Republika e Serbisë, për shkak të veprës penale kontrabandim me emigrantë nga neni 164 par.1, të KP-së, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësit të akuzuarit S. H, av.Valbonë Morina dhe përfaqësuesit të ndërmarrjes E sh.p.k., av.Idriz Daci, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.64/23, datë 13.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit S. H, av.Valbonë Morina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.64/23, datë 13.11.2023, VËRTETOHET.

II.HUDHET si e palejuar ankesa e përfaqësuesit të ndërmarrjes E sh.p.k., av. Idriz Daci.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.64/23, datë 13.11.2023 të pandehurin S. H për shkak të veprës penale *kontrabandim me*

emigrantë nga neni 164 par.1, të KP-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind) euro, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.05.2023 gjer në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Konform nenit 43 par.2 të KP-së, është i obliguar i akuzuari që dënimin me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind) euro të paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Konform nenit 43 par.3 të KP-së, nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 20 euro gjobë do të llogaritet barabartë me një ditë burgim.

Konform nenit 277 paragrafi 1 të KPP në lidhje me nenin 235 paragrafi 1 nënparagrafi 1.9 të KPP, i konfiskohet kamioni i markës “MAN”, ngjyrë e verdhë, me targa të regjistrimit ..., me numër të shasisë me rimorkio me targa me ngjyrë të verdhë, me numër të shasisë ..., leja e qarkullimit për kamion me numër serik ... e lëshuar nga MUP RS/PU Novi Pazar, leja e qarkullimit për rimorkio me numër serik ... e lëshuar nga MUP RS/PU Novi Pazar dhe çelësi i kamionit, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari S. H , që në emër të shpenzimeve gjyqësore – paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 200 euro si dhe të paguaj shumën prej 50 euro për programin për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësja e të akuzuarit S. H, av. Valbonë Morina, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të Kodit Penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj si të bazuar ankesën ashtu që aktgjykimin e shkallës së parë të prishë dhe t’a kthejë çështjen për rigjykim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i ndërmarrjes E sh.p.k, av. Idriz Daci, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe konfiskimin e kamionit, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta anuloj aktgjykimin e atakuar dhe automjeti-kamioni i konfiskuar t’i kthehet kompanisë- pronarit E sh.p.k Novi Pazar menjëherë.

Prokuroria e Apeli me shkresën PPA/I.nr.27/24 të datës 22.01.2024, ka propozuar që të refuzohen si e pabazuar ankesat e mbrojtësve të akuzuarit S. H, Valbonë Morina dhe av. Idriz Daci, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.64/23, datë 13.11.2023, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë, i akuzuari S. H , mbrojtësja e të akuzuarit S. H , av. Valbonë Morina, përfaqësuesi i ndërmarrjes E SHPK av. Idriz Daci, dhe përfaqësuesi i firmës E sh.p.k nga Novi Pazar D. N, ndërsa nuk ka prezantuar në seancë Prokurori i Apelit, edhe pse është njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Para se të filloj seanca kryetari i kolegjit gjykues e njofton mbrojtësin e të akuzuarit S. H , av. Idriz Daci se nga shkresat e lëndës rezulton se i njëjti ka bërë ankesë edhe në favor të akuzuarit S. Hedhe të ndërmarrjes Esh.p.k – Novi Pazar, të njëjtit i kërkon të sqarohet, av. Idriz Daci ka deklaruar se tërhiqet nga ankesa dhe mbrojtja lidhur me të akuzuarin S. H, kurse ngeli pranë përfaqësimit dhe ankesës së ndërmarrjes E sh.p.k – Novi Pazar, andaj ka deklaruar se automjeti është pronë e palës së tretë firmës E dhe pala e tretë nuk ka ditur nuk ka mundur të dijë se pasuria është mjetë për kryerjen e ndonjë veprë penale, andaj ka kërkuar që automjeti i ndaluar ti kthehet firmës, kurse mbrojtësja e të akuzuarit av.Valbonë Morina ka mbetur në tersi pran ankesës së dorëzuar ndërsa si shkaqe të ankesës shton edhe vendimin mbi sanksionin penal dhe ka propozuar që aktgjykimi të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim ndërsa i akuzuarit S. H ka mbështetur mbrojtësen e tij.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës, studioj aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-se dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit av.Valbonë Morina është e pa bazuar, ndërsa ankesa e përfaqësuesit të ndërmarrjes E Sh.p.k, hedhet si e palejuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit S. H , av.Valbonë Morina.

Në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit thekson se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 384 par.1 nënpar.1.2 në lidhje me nenin 38 par.2 si dhe neni 384 par.1 dhe par.2, nënpar.2.1, 2.4, 2.5, 2.6, dhe 2.7 të KPPK-së. Aktgjykimi është i paqartë dhe konfuz si dhe në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor. Gjykata nuk jep arsye të plotë se në cilat fakte është bazuar dhe cilat fakte konsiderohen të vërtetuara dhe të pavërtetuara në rastin e marrjes së aktgjykimit dënues. Shton se gjykata të mbrojtur tonë e shpall fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet si në aktgjykimin e ankimuar duke u mbështetur vetëm në deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarit, deklaratat këto të marra në procesverbalin e hetuesisë së veçantë, e nëse me kujdes e profesionalizëm vlerësohet ky procesverbal vërehet kjo se të njëjtit mundohen me deklaratimet

e tyre ti ikin përgjegjësisë së tyre duke e ngarkuar të akuzuarin dhe asnjëri nuk përputhet me deklaratat e njëri tjetrit. Tutje thekson se kemi të bëjmë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, konkretisht nenit 384 par.1 nëpar.1.2, në lidhje me nenin 38 par.2 të KPPRK-së, gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i kolegjit të Apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penale, ai anëtar i kolegjit shqyrtues ku në rastin konkrete trupi gjykues u përbërë nga kryetari i trupit gjykues gjyqtarja Ajser Skenderi, e cila ka marrë pjesë edhe në procedurën e mëparshme në këtë rast penal, përkatësisht në procedurën e hetuesisë së veçantë. Meqenëse çështja është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 384 par.1 nëpar.1.2 në lidhje me nenin 38 par.2 si dhe nenin 384 par.1 dhe 2, nëpar.2.1, 2.4, 2.5, 2.6 dhe 2.7 të KPPRK-së konsideroj se ka ardhur deri të vërtetimi jo i plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike, duke shkelur edhe ligjin penal në dëm të akuzuarit në rastin e marrjes së aktgjykimit dënues.

Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të ndërmarrjes E sh.p.k.

Në cilësinë e mbrojtësit të palës së dëmtuar ndërmarrjes E sh.p.k, në seancën e mbajtur në Gjykatën e Apelit, i njëjti deklaroi se tërhiqet nga ankesa dhe mbrojtja lidhur me të akuzuarin S. H, kurse ngel pranë përfaqësimit dhe ankesës së ndërmarrjes E sh.p.k. Në ankesë përfaqësuesi i ndërmarrjes E sh.p.k., ka theksuar se ndërmarrja në fjalë me seli në Novi Pazar, e cila është pronare e kamionit-rimorkios me të cilin kryen veprimtarinë e transportit ndërkombëtar, nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se pasuria e saj është përdorur si mjet për kryerjen e veprës penale të dyshuar nga i pandehuri vozitësi S. H, sipas tij nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 270 par.2 pika 2.1 dhe 2.2 i KPPRK-së, në lidhje me konfiskimin e automjetit. Andaj ka kërkuar që kamioni me rimorkio ti kthehet personit të tretë respektivisht ndërmarrjes E sh.p.k, në mënyrë që e njëjta të mos pësojë dëm të vazhdueshëm.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtjes, se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar,

po ashtu, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu, pra, konform dispozitave të nenit 370 par. 6 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to, ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.1 të KPP-së, kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga i akuzuari, e ka pranuar faktin se gjatë kontrollit në rimorkion e kamionit të tij nga polica janë gjetur katër persona por ka mohuar faktit të këtë qenë në dijeni për këtë rrethanë, me arsyetimin se të njëjtit kanë mundur të futen në kamionin e tij pa u vërejtur pasi që kjo shpesh ndodh në vend kalimet kufitare, pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimit të mbrojtëses së të akuzuarit se në rastin konkret kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, konkretisht nenit 384 par.1 nëpar.1.2, në lidhje me nenin 38 par.2 të KPPRK-së, kolegji penal e vlerëson si të pa bazuar pasi që dispozita e nenit 38 par.2 thekson se :”... *Megjithatë, gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues.*”. sipas kësaj dispozite rezulton se marrja e dëshmisë zbatohet në një seancë dëgjimore në të cilën gjyqtari i procedurës paraprake formon Panelin për Mundësin Hetuese të Veçantë për të siguruar efikasitetin dhe tërësinë e procedurës, e në rast se ngritët aktakuzë atëherë njëri gjyqtar anëtar i panelit duhet të jetë i kyçur drejtpërdrejt në marrjen e asaj prove dhe se marrja e provës në këtë procedurë zbatohet në pajtim me dispozitat që rregullojnë marrjen e dëshmive në shqyrtim gjyqësor, andaj edhe nuk paraqet bazë për përjashtimin e të njëjtit, edhe përkundër faktit se nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor gjatë prezantimit të trupit gjykues palët janë deklaruar pa vërejte.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e

administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri S, është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri S. H , në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin të aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor; Se me datë 16.05.2023, rreth orës 11:10, në pikën kufitare të Vërmicës është vërtetuar se me dashje merret me kontrabandim të migrantëve me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër nga hyrja e paligjshme e personave të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që pasi policia kufitare ndalon kamionin e markës “MAN” – me targa të Serbisë – pronë e personit juridik E me seli në Novi Pazar, të cilin kamion ishte duke e drejtuar i pandehuri dhe pas kontrollit të rimorkios së kamionit, me targa të regjistrimit ..., gjegjësisht pas hapjes së dyerve të saj, policia vëren katër (4) shtetas të huaj – emigrantë dhe atë: K.R, I.J, A.A – që të tre nga Maroku dhe Y.A nga Palestina, të cilët nuk kishin dokumente të identifikimit dhe pas intervistimit të tyre, të njëjtit kanë pranuar se kanë bërë ujdë me të pandehurin ashtu që ky i fundit u ka premtuar atyre se do t’i dërgojë deri në Serbi për shumën e të hollave prej 500 € (pesëqind euro) për secilin prej tyre – gjithsej 2.000 € (dymijë euro), të cilët janë pajtuar dhe e kanë siguruar të pandehurin se paratë do t’i pranoj përmes “Western Union” nga familjarët e tyre pasi të arrijnë në Serbi, e më pas i pandehuri është ndaluar nga ana e policisë së bashku me emigrantët, të cilët iu janë nënshtruar procedurave të rregullta nga autoritetet kompetente.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave në shqyrtimin gjyqësor siç janë; deklarata e dëshmitarit S. L, N. D, procesverbali i mundësisë hetuese të veçantë Ppr.nr.43/2023 të datës 19.05.2023 ku është dëgjuar dëshmitari K.R dhe dëshmitari I. J vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve të datës 16.05.2023, foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës me numër të rastit ... të datës 16.05.2023 dhe provat e tjera nga shkresat e lëndës. Dëshmitarët K. R dhe I. J shtetasve maroken të cilët në seancë kanë dëshmuar se në kamion kanë hyrë në atë mënyrë që vozitësi-këtu i akuzuari iu ka hapur derën, marrëveshja ka qenë që kur të mbërrin në Serbi secili prej tyre t ia paguajë shumën prej 500 euro si dhe që të dy dëshmitarët e dëgjuar gjatë seancës në sallën e gjyqimit e kanë identifikuar këtu të akuzuarin S. H si personin i cili i ka marr dhe i ka transportuar me kamion gjer në vendkalimin kufitar të Vërmicës ku edhe janë hasur nga policia, Kurse sa i përket elementit të dashjes nga ana e të akuzuarit kolegji vlerësoi se dashja është vërtetuar në momentin kur i akuzuari ka negociuar me dëshmitarët dhe u ka hapur derën e rimorkjos e që i njëjti ka qenë i vetëdijshëm për veprimin e vet.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lartë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë, e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar. Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, në ankesën kjo për faktin se veprimet e të akuzuarit i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale, për të cilat i njëjti është shpallur fajtor, se për këtë vepër penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit në këtë drejtim.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin lidhur me sanksionin penal.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se si shkaqe të goditjes së aktgjykimin mbrojtësja e të akuzuarit në seancën e kolegjit ka shtuar dhe vendimin mbi dënim, mirëpo nuk ka paraqitur arsyet e atakimit të aktgjykimit sa i përket kësaj baze ankimore megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoj edhe sa i përket kësaj bazë ankimore dhe gjeti se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat që konform dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka vlerësuar faktin se është hera e parë që i akuzuari ka ra në konflikt me ligjin, pasi që nuk ka ndonjë provë-aktgjykim të plotfuqishëm se i njëjti ka kryer edhe më herët ndonjë vepër penale, se është familjar, i martuar, i baba i tre fëmijëve. Ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tij në kryerjen e veprës penale-këtu i akuzuari vet e ka hapur derën e kamionit dhe i ka futur brenda migrantët në kamion-gjë që tregon edhe vendosmërinë e tij për të kryer veprën penale, motivi i kryerjes së veprës penale-që është për përfitim material, pasi secili prej migrantëve sipas marrëveshjes është dashur që t'ia paguaj nga 500 Euro, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, ku baza ndërkombëtare e inkriminimit të kësaj vepre penale është Protokollit kundër kontrabandimit të migrantëve përmes rrugëve, ujerave apo ajrit dhe se me këtë vepër penale mbrohen liritë dhe të drejtat themelore të migrantëve, si dhe regjimi i kalimit të ligjshëm të migrantëve prej një shteti në shtetin tjetër. Duke vlerësuar rrethanat e lartcekura të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj kjo Gjykatë

vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Gjithashtu kolegji trajtoj edhe ankesën e ushtuar nga përfaqësuesi i ndërmarrjes E sh.p.k., av.Idriz Daci dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se ankesa është ushtruar nga pala e cila nuk është palë në procedurë, ashtu që të njëjtën në kuptim të dispozitave ligjore konkretisht nenit 381 par.1 të KPP-së e cila dispozite parasheh se “*ankesë mund të paraqesin prokurori i shteti, i akuzuar, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit, i dëmtuari ose viktimave dhe mbrojtësi i viktimave apo përfaqësuesi i viktimës*”, andaj të njëjtën e hodhi si të pa lejuar për arsye se në rastin konkret personi në fjalë nuk e ka statusin as të palës së dëmtuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti Për Krime të Rënda
PAKR.nr.15/24, dt. 22.02.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale,
Blerina Sallauka

Anëtarët e kolegjit:
Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar kolegjit
Hashim Çollaku

Abdullah Ahmeti